



Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 320-8 750/24

Klinë, me 21.03.2024

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e kulturave të perimtarisë (furnizim me sera 100 m² dhe 32 m²).

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë- kulturës se perimtarisë, Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bën :

THIRRJE PUBLIKE

Fton fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ngritjes se serave në sipërfaqe prej 100 m² dhe 32 m².

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj :

- Me 70 % të kostos se seres, ndërsa fermeri me 30 %; dhe
- Dhënien e këshillave profesionale, përmes eksperteve të saj.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës se Klinës;
2. Të posedoj sipërfaqe të mjaftueshme të tokës për vendosjen e serës. Toka duhet të jetë në emër të aplikuesit apo ndonjërit nga familjaret e ngushtë apo të këtë kontratë të vërtetuar nga noteri për shfrytëzimin e saj;
3. Të këtë mundësi ujitje (posedon bunar);
4. Të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të mjeteve financiare në koston e serës;
5. Përparësi do të kenë fermerët nga zonat rural dhe ata të cilët nuk kanë përfituar para vitit 2023 nga projektet ngritjet e serave.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e plotësuar nga fermeri, e cila merret në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës;
2. Fleta poseduese;
3. Kopja e certifikatës se NIF-it;
4. Certifikata e vendbanimit;
5. Certifikata e bashkësisë familjare;
6. Kopja e letërnjoftimi.

Afati i aplikimit, është nga data 21.03.2024, deri me dt. 02.04.2024. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.



Drejtori i Drejtorisë se BPZHR

Lorenc Marleku